

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70010-25-11583-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

STUDIO HAPSIRA SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Mat - Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

045-150-123

(Numri Telefonit)

Edmond Halimi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

infostudiohdesign@gmail.com

(Adresa elektronike)

20.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

10000

(Kodi postar)

N/A

(Numri i Faks-it)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Më datën 30.05.2026 është publikuar njoftimi për kontratë.

- Afati i dorëzimit ofertave , data 12.05.2026 koha 14:00 E-PROKURIM
- Hapja e ofertave po të njëjtën datë : 12.05.2026 koha 14:00 E-PROKURIM
- Vendimi për Eliminimin tonë- Letrat Standarde me datë : 19.06.2026
- Vendimi për refuzimin e kërkesës për Ri-Shqyrtim të datës :09.07.2026
- Kriteri i dhënies Kontratës : Çmimi më i ultë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së paragrafi 4
Neni 69 i LPP-së paragrafi 1
Neni 26 i RrPP-së paragrafi 15
Neni 40 i RrPP-së paragrafi 1,2, 12 dhe 13
Neni 45 i RrPP-së paragrafi 45.21

Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne si Grup i Operatorëve Ekonomik : Studio Hapsira SHPK & Geoplan Consulting Group & Taulant SHPK (tutje e gjeni si **Studio Hapsira SHPK** si Lider.) më datë **12.05.2026** kemi dorëzuar ofertën tonë për aktivitetin e prokurimit: **“Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës”**, ndërsa më datë **19.06.2026**, Autoriteti Kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, ka shpalluar GOE **Pro Architecture & Arbër Shala**

Architects SHPK & N.N. Pro Art " me qmimin më të shtrejtë edhe pse kriter i dosjes ka qenë qmimi më i lirë.

Më datën : 07.07.2026 Kemi pranuar qasje tek Autoriteti Kontraktues Spitali Regjional Prizren , ku pas shqyrtimit të dokumentacionit kemi konstatuar që deklarata e themelimit të Grupit Operatorve nuk është konform formularit zyrtar të Miratuar nga KRPP , po ashtu një vlerësim jo i duhur i metodologjisë nga Komisioni Vlersues i cili nga ka poentuar më së paku pikë në krahasim me ofertat tjera.

Më datën **07.02.2026** Autoriteti Kontraktues **Spitali Regjional Prizren** ka refuzuar **kërkesën për rishqyrtim me arsyetim :**



Në mbështetje të Nenit 108/A par.10.1 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, duke u bazuar në Nenin 8 par.8.1.1 pika iii) lidhur me Nenin 7 par.7.1 pika d) të Rregullave për parashtrimin e ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 07/07/2026 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **STUDIO HAPSIRA SH.P.K.**, për aktivitetin e prokurimit " **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës** " me nr. të prokurimit: 220/70010-25-11583-2-1-1 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit ekonomik " **STUDIO HAPSIRA SH.P.K** e datës 07.07.2026 kundër Njoftimi mbi vendimin e kontratë e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit " **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës** " me nr. të prokurimit: 220/70010-25-11583-2-1-1
2. Vërtetohet Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit " **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës** " me nr. të prokurimit: 220/70010-25-11583-2-1-1
3. Vazhdohet me aktivitetin e prokurimit " **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës** " me nr. të prokurimit: 220/70010-25-11583-2-1-1 Ky Vendim mbetet në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën e eprokurimit për të gjithë palët e interesuar për aktivitetin e prokurimit në fjalë, adresa: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Operatori Ekonomik " **STUDIO HAPSIRA SH.P.K** me datën 07.07.2026 si palë e pa kënaqur ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 02.07.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit " **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës** " me nr. të prokurimit: 220/70010-25-11583-2-1-1 duke supozuar se janë shkelur dispozitat e LPP-së dhe Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Autoriteti Kontraktues me datë 09.07.2026 brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

PRETENDIMI NR 1 :

Grupi i OE : PRO ARCHITECTURE & ARBËSHALA ARCHITECTS & N.N.P PRO ART

Deklaratën e themelimit nuk e kanë dorëzuar sipas ANEKSIT 7 të dosjes tenderit faqe 31 FDT , dhe duhet shpallet e pa përgjegjeshme , pasi është formular standart të miratuar nga KRPP , e njëjta është futur në dosjen e tenderit , po ashtu Qeshtja e Aneksit 7 (Deklara për themelim Grupit) është trajtuar edhe në disa vendime të OSHP ku kompanitë i ka shpalluar të pa përgjegjeshme. Në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe përkundër faktit se i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)

I.Përgjigje në pretendimin ankimor :

Komisioni Vlerësues ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomikë dhe ka konstatuar se Deklarata për Themelimin e Grupit është dorëzuar dhe përmban të gjitha elementet thelbësore të kërkuara për funksionimin e grupit të operatorëve ekonomikë. Mosparaqitja e dokumentit në formatin identik të Aneksit 7 nuk përbën, në vetvete, bazë për shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme, përderisa përmbajtja e dokumentit i përmbush kërkesat materiale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dëshmon marrëveshjen ndërmjet anëtarëve të grupit.

Referimet e ankuesit në vendime të tjera të OSHP-së nuk janë automatikisht të zbatueshme në këtë procedurë, pasi çdo rast vlerësohet mbi bazën e fakteve dhe dokumentacionit konkret të dorëzuar në aktivitetin përkatës të prokurimit.

Për rrjedhojë, pretendimi se oferta e grupit të operatorëve ekonomikë duhet të shpallet e papërgjegjshme vetëm për shkak të mosdorëzimit të deklaratës sipas formatit standard të Aneksit 7 nuk gjen mbështetje në rrethanat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe, si i tillë, refuzohet si i pabazuar.

PRETENDIMI NR 2 :

Vlerësimi jo i Duhur për kundër Konceptit me të mirë më të trajtuar , komisioni vlerësimit na ka nënqmuar duke na dhënë minimumin dhe Pikëve Autoriteti Kontraktus gjatë vlerimit tenderit tonë nuk ka vepruar në përputhje me NENI 52 dhe 69 LPP , duke favorizuar kompanin e rekomanduar për Kontratë

Në kemi analizuar Koncept Propozimit tonë Në Krahësim me Konceptine propozuar nga Kompania rekomanduar për Kontratë

Kompania e propozuar për kontratë ka propozuar një Koncept Popozimi gjeneral , ndërsa ne si kompani kemi propozuar një koncept detalduke i paraqitet të gjithë specifikimet teknike të përcaktuar në paramas dhe parallogari dhe detyrë Projektuese

BAZUAR NË ANALIZË E KONCEPTIT DHE ZGJIDHJES PROPOZUAR KOMPANISË REKOMANDUAR

1 . Nuk ka dorëzuar Organokramin në mënyrë grafike të detajuar sipas kërkesave të dosjes tenderit mbi stafin e kërkuar dhe të angazuar ,

2. Nuk ka dorëzuar Planin dimanim në mënyrë grafike

3 Nuk e ka trajtuar Arkitekturen e Objekteve Ekzistuese :

☐ Planin e Rilevimit

☐ Plan Sistemimin

- ☐ Planimetritë e objektit
- ☐ Prerje tërthore dhe horizontale
- ☐ Fasada
- ☐ Pamje Aksionometrike
- ☐ Pamje/Render
- ☐ Detaje Arkitektonike
- ☐ Planimetria e Ndrëqimit
- ☐ Plani i mobilimit

4. Nuk e ka Trajtuar Planin i Strukturës Objekteve Ekzistuese :

- ☐ Planin e Rilevimit
- ☐ Plani i Themeleve
- ☐ Struktura
- ☐ Detaje Teknike

5. Nuk e ka trajtuar Planin Elektrik

- ☐ Instalimi i prizave dhe fuqisë
- ☐ Instalimi i ndriqimit
- ☐ Instalimin e rrjetit Lan
- ☐ Detaje Elektrike

7. Nuk e ka Trajtuar Projekti mekanik (hidraulik)

- ☐ Plani i Furnizimit me ujë sanitar
- ☐ Shkarkimi i ujerave të zeza

8. Nuk e ka trajtuar Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit.

- ☐ Sis. Dedektimit - Lajm. Te Zjarrit

- 9. Nuk është trajtuar Projekt i Personave me aftësi të kufizuara.

2. Përgjigje në pretendimin ankimor :

Sipas dosjes së tenderit është kërkuar që Metodologjia e propozuar të bazohet si në vijim:

a) Përfaqësja teknike dhe metodologjia

OE duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përfaqëson teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve

b) Plani i punës

Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përfaqësimin teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

c) Aftësia organizative e stafit

OE duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e ekipit të tij.

d) Afatet e propozuara

OE duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit.

Vlerësimi është bërë ashtu si edhe është kërkuar në dosje të nderit në mënyrë proporcionale për të gjitha pikat. Në bazë të kësaj edhe është vlerësuar "Metodologjia e propozuar" e Grupit të Operatorëve Ekonomik Proarchitecture SH.P.K. Arbër Shala Architects, SH.P.K. Hilmi Mulaku B.I

Ku bazuar në dokumentin "Metodologjia e Propozuar" dokumenti përmban një përshkrim të detajuar të metodologjisë, planit të punës, strukturës organizative, sistemit të kontrollit të cilësisë dhe afateve të realizimit

Kriteri	Pikët
a) Përfaqja teknike dhe metodologjia	25
b) Plan i punës	25
c) Aftësia organizative e stafit	20
d) Afatet e propozuara	25
Totali	95/100 pikë

Arsyetimi

Operatori ekonomik ka dëshmuar kuptim të plotë të objektit të kontratës dhe të kërkesave të Termave të Referencës, duke paraqitur një metodologji të detajuar dhe një qasje të integruar multidisiplinare. Janë përshkruar fazat e analizës, organizimit të ekipit, koordinimit me Autoritetin Kontraktues, kontrollit të cilësisë dhe integritetit të paramasave dhe preventivave gjatë fazës së projektimit.

Plan i punës është i strukturuar në faza të qarta, me përshkrim të aktiviteteve dhe rezultateve të pritshme për secilën fazë. Operatori ekonomik ka demonstruar aftësinë për të transformuar kërkesat e Termave të Referencës në një plan konkret pune, me organizim logjik dhe fleksibilitet operacional.

Operatori ekonomik ka paraqitur strukturën organizative dhe funksionet e ekipit profesional, duke përfshirë menaxherin e projektit, koordinatorët e disiplinave, njësinë e mbikëqyrjes profesionale dhe njësinë e kontrollit të cilësisë. Megjithatë, në dokumentin e paraqitur nuk identifikohen emrat dhe angazhimet individuale të ekspertëve, prandaj vlerësimi nuk propozohet maksimal.

Janë paraqitur aktivitetet kryesore, fazat e realizimit, kohëzgjatja e secilës fazë, afatet orientuese të dorëzimit dhe mekanizmat për trajtimin e rasteve urgjente. Afatet e propozuara janë të qarta dhe tregojnë ndërlidhjen logjike ndërmjet fazave të projektit.

Metodologjia e propozuar nga ana juaj përmban referenca të shumta të legjislacionit dhe institucioneve të Republikës së Shqipërisë (ZRPP, ALUIZNI, KESH-OSSHE), si dhe përmenden objekte të shkollave profesionale dhe nxënës, gjë që dëshmon se dokumenti nuk është hartuar specifikisht për nevojat dhe kuadrin ligjor të institucioneve shëndetësore në Kosovë. Ky vlerësim reflekton diferencën e madhe në profesionalizëm dhe përkushtim në krahasim me ofertuesit e tjerë që kanë dorëzuar metodologji të përshtatshme për kontratat kornizë spitalore

Mangësitë e evidentuar:

- Dokumenti duket i përshtatur nga praktika në Shqipëri.
- Nuk fokusohet mjaftueshëm në specifikat e infrastrukturës spitalore.
- Ka shumë elemente të përgjithshme.

Për rrjedhojë, pretendimi se Metodologjia e propozuar nga ana juaj është dashtë të vlerësohet më mirë se Metodologjia e propozuar nga Grupi i operatorëve ekonomik fitues nuk ekziston

Nga konstatimet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, ankuesi mund të paraqes në çdo rast, një ankese pranë OSHP-së në pajtim me Nenin 109 të LPP-së brenda 10 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Data: 09.07.2026, Prizren

Menaxheri i Prokurimit

Mr.Sc.Sani Ahmetaj





PERETENDIMI ANKIMORË 1 :

Grupi Operatorëve Ekonomik : Pro Architecture & Arbër Shala Architects SHPK & N.N. Pro Art kan prezentuar Deklaratën e Themelimit Grupit nuk është konform formularit zyrtar të Miratuar nga KRPP

Në bazë të nenin 71 të Ligjit Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, përfaqësuesit e grupit të Operatorëve Ekonomik, me datë 08.05.2026, nënshkruajnë këtë:

DEKLARATË

PËR THEMELIMIN E GRUPIT TË OPERATORËVE EKONOMIK

Për aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojës

Numri i prokurimit: 220/70010-25-11583-2-1-1

Autoriteti Kontraktues: Spitali Regional - Prizren

- 1) "Proarchitecture" shpk, NUI: 811106691, rr. Rrustem Hyseni Historiani, nr. 3, 42000, Vushtrri, Kosovë, përfaqësuar nga Arsim Gërxhaliu
- 2) "Arbër Shala Architects" shpk, NUI: 810393273, rr. Bajram Veliu, nr. 13, 21000, Rahovec, Kosovë, përfaqësuar nga Arbër Shala
- 3) N.N.P. "Pro Art", NUI: 810445884, rr. Fatime Hetemi, nr. 27, 10000, Prishtinë, Kosovë

a. DEKLARATË: Ne anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe në rast se grupit i jipet kontrata, jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

b. DEKLARATË: Ne anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe vërtetojmë se ne nuk jemi duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër, që marrin pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit.

c. DEKLARATË: Ne anëtarët e grupit e autorizojmë "Proarchitecture" shpk si lider të grupit kryesor për të vepruar në emër të grupit.

d. DEKLARATË: Ne anëtarët e grupit konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojmë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

Ne anëtarët e grupit në fjalë jemi së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para Autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jipet grupit në fjalë, ne gjithashtu jemi së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë.

"Proarchitecture" shpk
Arsim A. Gërxhaliu


08.05.2026

Përfaqësues i autorizuar: Arsim A. Gërxhaliu

Data: 08.05.2026,


proarchitecture

"Arbër Shala Architects" shpk

Arbër Shala


08.05.2026
ashla
ARBËR SHALA
architects
Grupi dhe përgjegjësi
i bashkuar

N.N.P. "Pro Art"

Hilmi Mulaku


08.05.2026

Aneksi XX DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT

Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupit/apo konzorciumi që aplikon

Për: [shëno emrin e AK]
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [shëno emrin e Grupit te OE]
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: [shëno titullim e Aktivitetit te prokurimit]

Numri i Prokurimit: [shëno numrin]

Hyjnë në bashkëpunim si Grup i Operatoreve Ekonomik , për qëllim të këtij tenderi me titull: [shëno titullim e Aktivitetit te prokurimit] me numër te prokurimit [shëno numrin].

Ne, Grupi i Operatoreve Ekonomik në përbërje të anëtarëve të grupit:

I. [shëno emrin e anëtarit të grupit - Liderit]
Shëno emrin e anëtarit të grupit - Liderit Shëno adresën

II. [shëno emrin e anëtarit të grupit]
Shëno emrin e anëtarit të grupit Shëno adresën

shto sipas nevojës

Datë: []

Vendi: []

Anëtarët e grupit lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë:

- Ne të gjithë** anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.
- Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- Ne të gjithë anëtarët e grupit e** autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: [shëno emrin e liderit të grupit]
- Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.
- Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është:

a) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës se Liderit]

b) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës e anëtarit]

31

Shto sipas nevojës ...

31

- Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:

a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit]

b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit]

Shto sipas nevojës ...

- Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.

- Ne të gjithë anëtarët e grupit** pranojmë që: nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me anëtarin e mbetur, nëse anëtar i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Emri i Operatorit Ekonomik (lider) _____

Emri Mbiemri _____

Data/ Nënshkrimi/ Vula _____

Anëtarët e tjerë të grupit:

Emri i Operatorit Ekonomik (anëtar) _____

Emri Mbiemri _____

Data/ Nënshkrimi/ Vula _____

Shto sipas nevojës

Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar) _____

Data/Nënshkrimi / Vula _____

Bazuar- RREGULLOREN Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar) Ky version i Konsoliduar i RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK nuk është zyrtar dhe është përgatitur për nevojat e brendshme të KRPP-së, AQP-së, OSHP-së, Autoritetet Kontraktuese, Operatorët ekonomik dhe personat tjerë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit. Teksti me ngjyrë të gjelbërt është Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.001/20022 për prokurimin publik që hynë në fuqi nga 11.11.2024 , NENI 26.15 (GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK)

26.15 Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP.

Autoriteti Kontraktues në përgjigjen për e refuzimin të pretendimit ankimorë nuk e ka mbështetur në asnjë bazë ligjore lidhur me mos dorëzimin e deklaratës së themelimit grupit konform dosje tenderit dhe formularit të miratuar nga KRPP.

1. Përgjigje në pretendimin ankimor :

Komisioni Vlerësues ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomikë dhe ka konstatuar se Deklarata për Themelimin e Grupit është dorëzuar dhe përmban të gjitha elementet thelbësore të kërkuara për funksionimin e grupit të operatorëve ekonomikë. Mosparaqitja e dokumentit në formatin identik të Aneksit 7 nuk përbën, në vetvete, bazë për shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme, përderisa përmbajtja e dokumentit i përmbush kërkesat materiale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dëshmon marrëveshjen ndërmjet anëtarëve të grupit.

Referimet e ankuesit në vendime të tjera të OSHP-së nuk janë automatikisht të zbatueshme në këtë procedurë, pasi çdo rast vlerësohet mbi bazën e fakteve dhe dokumentacionit konkret të dorëzuar në aktivitetin përkatës të prokurimit.

Për rrjedhojë, pretendimi se oferta e grupit të operatorëve ekonomikë duhet të shpallet e papërgjegjshme vetëm për shkak të mosdorëzimit të deklaratës sipas formatit standard të Aneksit 7 nuk gjen mbështetje në rrethanat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe, si i tillë, refuzohet si i pabazuar.

Në rastin konkret AK është dashur ta shpall të pa përgjegjshme , pasi Deklarat e formulimit të Grupit përveq që është jashta formulariit standard të Miratuar nga KRPP-ja, nuk i plotë as kriteret minimale administrative të përcaktuara NENI 26.15 RRUOP si dhe në Gormularin e përcaktuar nga KRPP-ja

- **Mungon përcaktimin e përqindjes së shpërndarë për realizimin e Kontratës nga nga Lideri dhe Antarët e Grupit**
- **Mungon Përcaktimin Përgjegjësia e realizimit kontratës nga Lideri dhe Antarët tjerës**
- **Në rast të shfrytëzimit të drejtës Ankesë nuk është përcaktuar se cili Antarë mund ta Ushtrojë atë të drejtë.**

Bazuar në praktikat e Gjykatave , po ashtu edhe të OSHP-së , Vendimet e tyre për ankesa dhe pretendime të njëjta konsiderohen të gjykuara “ Rest Juridicata” si psh në vendimet e OSHP-së , REFEROJU VENDIMEVE TË OSHP : 2025/1072 -Trajton të pa përgjegjësime Deklaratën e themelimit Grupit jashta formularit Standard të miratuara nga KRPP
VENDIMI I OSHP 2025/1172- Trajton këtë qeshtje ndërhyrje në Deklarat e Themelimit Grupi dhe sqaron rendesi themelimit grupit konfoirm Aneksit 7.

NENI 44 RRUOP (FORMULARËT STANDARD)

44.1 AK do të përgatisë dokumentet e tyre të prokurimit duke përdorur formularët përkatës standard që do të gjenden në faqen e internetit të KRPP-së.

44.4 Gjithashtu, AK gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit, përveç anekseve standarde pjesë të Dosjes së Tenderit, mund të shtoj Aneksë tjera si Formularin për themelimin e Grupit të OE, Formularin për Autorizimin nga Prodhuesi, Formularin për listën e projekteve të realizuara etj.

KONKLUZION NË PRETENDIMIN NR1 :

Dokumenti i prezentuar nga Grupi OE Pro Architecture & Arbër Shala Architects SHPK & N.N. Pro Art , nuk e plotësojnë kushtin administrativë (Mungon përcaktim i shpërndarjes përqindjes për realizim kontratës nga Lideri dhe të gjithë antarët tjerë, nuk është përcaktuar përgjegjësia për realizim kontratës nga Lideri dhe të gjithë antarët tjerë).

AK për kundër pregaditjes Formularit Standard në Dosje tenderit faqe Nr 31 të FDT-së (Deklarat Për themelim të Grupit) , gjatë vlerësimit tenderit i ka ikur një kriteri të tillë duke anashkaluar Grupin e Operatorve të cilët nuk e ka plotësuar ,nënshkruar dhe vulosur në formularë të tillë.

Kusht Administrativë : Grupi OE i rekomanduar për kontratë duhet shpallet i pa përgjegjësëm



PERETENDIMI ANKIMORË 2 :

Vlerësimi jo i Duhur për kundër Konceptit me të mirë më të trajtuar , komisioni vlerësimi na ka nënqmuar duke na dhënë minimumin dhe Pikëve Autoritei Kontraktus gjatë vlerimit tenderit tonë nuk ka vepruar në përputhje me NENI 52 dhe 69 LPP , duke favorizuar kompanin e rekomanduar për Kontratë

Ne kemi analizuar Koncept Propozimit tonë Në Krahësim me Konceptine propozuar nga Kompania rekomanduar për Kontratë

Kompania e propozuar për kontratë ka propozuar një Koncept Popozimi gjeneral , ndërsa ne si kompani kemi propozuar një koncept detalduke i paraqitet të gjithë specififikimet teknike të percaktuar në paramas dhe parallogari dhe detyrë Projektuese

Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS ²

[Elementet e mëposhtme për përcaktim të kriterëve nuk janë të vetmet kriterë dhe nuk janë obligative. Kriteret duhet të zgjedhën sipas nevojës së Autoritetit Kontraktues dhe lëndës së kontratës.]

Kategoritë	Përshkrimi i kriterëve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
1	Oferta Financiare Pikët <100x40%> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht Oferta ekonomikisht me e favorshme Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas ofertës ekonomikisht më të favorshme	40 %	$P = \frac{P_s}{P_t} \times [100x\%]$
2	Metodologjia e Propozuar a) Përqasja teknike dhe metodologjia, b) Plani i punës c) Aftësia organizative d) Afatet e Propozuara / plani dinamik më i shkurtë	30 %	$O = \frac{O_s}{O_t} \times [100x\%]$

Të Kategoria 2-

a) Përfaqja teknike dhe Metodologjia

b) Plani i Punës

c) Aftësia Organizative

d) Afatet e propozuar /Afatet planin Dinamik më i shkurtë

Ne si Grup OE Studio Hapsira SHPK & Geoplan Consulting Group & Taulant SHPK kemi dhënë përfaqshen teknike dhe metodologjinë më të avancuar dhe më të detalizuar së sa GOE i rekomanduar përmenduar këto Fakte si në vijim :

Në kuadër paragrafit 1.1.1 Përfaqshen Teknike – Kemi specifikuar legjislacionin në fuqi , po ashtu edhe të gjitha standardet e ndërtimit : Orientimi Arkitektonik të ndërtesave , funksionalizimi dhe leksibilitetin e ndërtesave , zyrat në ambientet punuese, nyjet sanitare , kabinetet , brezin e gjelbërt , orinetimin e Strukturave ku janë specifikuar materialet, metodologjinë e llogaritjeve të strukturave , arkitekturë në të gjitha fasad e batimit , trajtimi i ujërave e pijes dhe të zeza , instalimet elektrike , ngrohjes dhe ventimllimit.

BAZUAR NË ANALIZË E KONCEPTIT DHE ZGJIDHJES PROPOZUAR KOMPANISË REKOMANDUAR

1 . Nuk ka dorëzuar Organokramin në mënyrë grafike të detajuar sipas kërkesave të dosjes tenderit mbi stafin e kërkuar dhe të angazuar ,

2. Nuk ka dorëzuar Planin dimanim në mënyrë grafike

3 Nuk e ka trajtuar Arkitekturën e Objekteve Ekzistuese :

- ✓ Planin e Rilevimit
- ✓ Plan Sistemimin
- ✓ Planimetritë e objektit
- ✓ Prerje tërthore dhe horizontale
- ✓ Fasada
- ✓ Pamje Aksionometrike
- ✓ Pamje/Render
- ✓ Detaje Arkitektonike
- ✓ Planimetria e Ndriçimit
- ✓ Plani i mobilimit

4. Nuk e ka Trajtuar Planin i Strukturës Objekteve Ekzistuese :

- ✓ Planin e Rilevimit
- ✓ Plani i Themeleve
- ✓ Struktura
- ✓ Detaje Teknike


5. Nuk e ka trajtuar Planin Elektrik

- ✓ Instalimi i prizave dhe fuqisë
- ✓ Instalimi i ndriçimit
- ✓ Instalimin e rrjetit Lan
- ✓ Detaje Elektrike

I mungon në kuadër planit punës edhe faza e mbikqyrjes projekteve deri në pranim teknike , pasi është pjesë e detyrë projektuese , dosjes tenderit , dhe paramasës dhe parallogarisë

GOE rekomanduar për kontratë a afua në planë tekstual të përgjithshëm mbi afatet e realizimit kontratës i cili është i mangët , në krahasim me Grupin tonë i cila ka ofruar në plan dinamik të detajuar në menyre tabelare duke i specifikuar ditë , javët dhe muajin e relizimit të çdo Projekti.

GOE ka ofruar në Skemë Organizative të stafit të përgjithshme pa specifikuar vijën e hirakisë dhe mënyrat e marrjes përgjegjësisë i cili është i mangët në krahasim me skemën Organizative (organogramin të cilin e kemi paraqitur në mënyrë Grafike)



Koment nuk e kuptojmë vlerësimin e jurisë të na vlerësojmë minimalisht me 10 pikë kur metologjia , skema organizative (Organogrami) si dhe plani dinamik i punës është më i kompletuar me i detalizuar , po ashtu edhe i paraqitur edhe formë grafike në krahasim me OE të rekomanduar për Kontratë , duke marrë parasysh që zhvillimi i termave referencë (TOR)të Pregaditur nga autoriteti Kontraktues kanë qenë të përgjithshme .

Komisioni Vlerësues :

Kriteri 3: Qëndrueshmëria e Propozuar

- **Pikët e dhëna: 10 / 30 Pikë**
- **Arsyetimi:** OE propozon që qëndrueshmëria e projektit të mbështetet mbi tre studime bazë inxhinierike: Studimi Topografik (rilevimi i kuotave), Studimi Gjeologjik (qëndrueshmëria e dherave, veçanërisht për mjediset nëntokësore, shoqëruar me shpime e fotografi), dhe Studimi Hidrologjik (drenazimi i ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë).
- Edhe pse këto studime janë të domosdoshme për çdo ndërtim, ato përfaqësojnë vetëm minimumin e kërkuar inxhinierik dhe nuk ofrojnë asnjë zgjidhje moderne të qëndrueshmërisë. "Studio Hapsira" nuk përmend asnjë standard të efikasitetit energjetik (si klasa A+), nuk integron panele fotovoltaike, nuk citon kode ndërkombëtare (Eurocodes, ISO, DIN, EN) dhe nuk ofron asnjë inovacion teknologjik si sistemi BIM, që u prezantuan gjerësisht nga konkurrentët e tjerë në këtë tender.

PIKËT TOTALI: 30 / 100 Pikë

Nuk ka bërë vlerësim të duhur dhe përcaktim të pa saktë në krahasim me gjendjen faktike të dokumentacionit teknik të dorëzuar , pasi në metologji tonë Si grup OE i kemi dorëzuar të gjitha standardet për projektim :

- *Standardet teknike që zakonisht kërkohen në Kosovë*

Edhe pse nuk janë gjithmonë të shkruara direkt në ligj, në projektim praktik kërkohen:

Eurocode EN 1990–1998

EN për HVAC

ISO 7396 për gazra medicinale

IEC 60364-7-710 për instalime elektrike medicinale

EN 13501 për zjarr

ISO për clean rooms

ASHRAE healthcare ventilation guidelines

-EN 1990:2002 Eurokodi: Bazat e Projektimit të Konstruksioneve të Ndërtimit.

-EN 1991:2002 Eurokodi 1: Veprimet mbi strukturat (Pjesa 1-1)

-EN 1992:200X Eurokodi 2: Projektimi i konstruksioneve betonarme-Pjesa 1-1: Te përgjithshme-Rregulla të përgjithshme për ndertesat dhe Veprat inxhinierike.

-EN 1996:200X Eurokodi 6: Projektimi i ndertesave me mure mbajtëse-Pjesa 1-1: Te përgjithshme-Rregullat për muraturen e armuar dhe të pa armuar.

Në kuadër të standardit IEC 60364-7-710 , ky standard e trajton edhe efikasitetin e energjisë, për dallim me GOE të rekomanduar i cili nuk ka afruar asnjë standard , është e pakuptimtë dhe diskriminuese pasi komisioni vlerësimi vetëm neve na kanë përcaktuar në arsyetimin evlersimit pikëve , duke marrë parasysh që GOE i rekomanduar ska afruar asnjë standard dhe është vlersuar maksimalisht me pikë në krahasim me metologjinë tonë , duke nënvlersuar metologjinë tonë dhe njëkosisht duke favorizuar GOE e rekomanduar.

Vlerësimi është në kundërshtim me NENI 40 RRUOP paragrafi 1 , 2

40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP.

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacionet ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendimet të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Përgjigja Nr 1 :

Metodologjia e propozuar nga ana juaj përmban referenca të shumta të legjislacionit dhe institucioneve të Republikës së Shqipërisë (ZRPP, ALUIZNI, KESH-OSSHE), si dhe përmenden objekte të shkollave profesionale dhe nxënës, gjë që dëshmon se dokumenti nuk është hartuar specifikisht për nevojat dhe kuadrin ligjor të institucioneve shëndetësore në Kosovë. Ky vlerësim reflekton diferencën e madhe në profesionalizëm dhe përkushtim në krahasim me ofertuesit e tjerë që kanë dorëzuar metodologji të përshtatshme për kontratat kornizë spitalore

Koment ;

Njëri nga Anatrës e Konzorciumit tanë Taulant SHPK është nga Shqipëria i cili ka marr pjesë në përpilimin e metodologjisë , metodologjia është në gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare në LPP , terminologji Shqiptare nuk mund të Justifikohet për zvoglimin e pikëve gjatë vlerësimi është e rregulluar me NENI 45.21 RRUOP , nëse ka parqartësi apo gabime tekstuale të cilat janë të qarta duhet kërkojë sqarim Konfom NENI 59.2 LPP-së

45.21 Neni 59.4 i LPP-së kërkon që gabimet dhe mangësitë duhet të korrigjohen dhe që devijimet e vogla duhet të kuantifikohen. Gabimet dhe mangësitë janë të ndryshme nga ato aritmetike që trajtohen në nenin 41.9 të kësaj rregullore. Gabimet dhe mangësitë mund të jenë tekstuale ose ato mund të prekin aspekte të tjera të tenderit. Gabimet tekstuale dhe mangësitë duhet të jenë objektivistisht shumë të qarta dhe se autoriteti kontraktues të jetë në gjendje të identifikimit të tyre si gabime dhe mangësi! Çdo paqartësi apo kundërthënie që nuk mund lehtë të identifikohet si një gabim apo mangësi nuk mund të korrigjohet. Autoriteti kontraktues duhet në raste të tilla të vazhdojë duke kërkuar sqarim në bazë të nenit 59.2 të LPP. Kuantifikimi i devijimeve të vogla ka për qëllim të neutralizimit të efektit që këto devijime do të kenë në krahasimin e tenderëve. Llogaritja duhet të përfundojë duke u shprehur në disa vlera të shprehura në terma monetare.

Përgjigja Nr 2 :

Operatori ekonomik ka paraqitur strukturën organizative dhe funksionet e ekipit profesional, duke përfshirë menaxherin e projektit, koordinatoret e disiplinave, njësinë e mbikëqyrjes profesionale dhe njësinë e kontrollit të cilësisë. Megjithatë, në dokumentin e paraqitur nuk identifikohen emrat dhe angazhimet individuale të ekspertëve, prandaj vlerësimi nuk propozohet maksimal.

Në mbrojtje e vendimit AK është arsyetuar se OE ka ofruar Strukturën Organizative , korrdinatorët e diciplinave , njësit e mbikqyrjes , mirpo dokumenti i paraqitur nuk identifikon Emrat dhe angazhimet individuale të Ekspertëve .

Nëse analizohet dokumenti i prezentuar nga GOE i rekomanduar nuk ka paraqitur Organogram organizimit po ashtu as emra të ekeprteve të angazhuar dhe përkundrazi është vlerësuar maksimalisht me pikë , kjo shihet qasje Diskriminuese për Kompanin tonë po ashtu edhe favorizuese për kompanin Rekomanduar , duke mos përdorur standarde të drejta për vlerësim ofertave për të gjithë OE rekomanduar për kontratë.

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.
4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.
5. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar.

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Organit Shqyrtues të Prokurimit, i propozojmë që të merr këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** tërësisht e bazuar Ankesa e parashtruar nga OE Studio Hapsira SHPK & Geoplan Consulting Group & Taulant SHPK
- II. ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 19.06.2026, ashtu që **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues SPTALI RAJONAL PRIZREN , që lëndën ta kthejë në **RIVLERËSIM** dhe pas rivlerësimit OE Studio Hapsira SHPK & Geoplan Consulting Group & Taulant SHPK . të shpallet fituese si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.
- III.** Meqë ankesa e OE Studio Hapsira SHPK & Geoplan Consulting Group & Taulant SHPK ishte e suksesshme, lejohet kthimi i tarifës së ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ne si OE kemi pësuar dëme të konsiderueshme. Dëmet e pësuar (materiale dhe jo materiale) deri në këtë fazë të procedurës janë në vlerë 170,000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*